

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS–kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Isa Kelmendi, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses Sh. Zh., nga Komuna e ..., të cilën me autorizim e përfaqëson B. J., avokat nga ..., kundër të paditurës Komuna e Podujevës, të cilin e përfaqëson Faik Rama, objekti i kontestit anulimi i vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kompensimi i të ardhurave personale, duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr .671/2016 të datës 22.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10.tetor.2018, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr .671/2016 të datës 22.05.2018.

#### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Apelit të Kosovës, Ac.nr .671/2016 të datës 22.05.2018 është refuzuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë ,C.nr.24/2015 datë 18.12.2015, me të cilën është obliguar e paditura që në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi ta kthejë paditësen në detyrat e punësi mësimdhënëse për punë praktike me normë të plotë të orëve deri në moshën e pensionimit 65 vjeçare, si dhe paditëses të kompensoj të ardhurat personale dhe stimulimet tjera dhe atë në periudhën prej 01.09.2014 e gjerë në muajin dhjetor 2015, në shumën prej 7.516,76 € , me kamatë prej 3,5 % që paguajnë bankat në mjetet e deponuara mbi një viti pa destinim të caktuar si dhe pagesën e të ardhurave tjera personale deri në kthimin e vendin e punës mësimdhënësit si

dhe. Obligohet e paditura që paditëses t'i paguajë shpenzimet procedurale në shumën prej 813 € në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si i bazuar revizioni i të paditurës dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë të prishen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar fakti se paditësja që nga viti 1991 e deri më 31.08.2014, dhe se për vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014 ka pasur të lidhura me të paditurën kontratat e punës një vjeçare. E paditura ka shpallur konkursin publik për vendin e punës mësimdhënëse në SHMT "Fan Noli" në ..., në të cilën paditësja ka konkurruar pasi që ka plotësuar të gjitha kushtet por është pranuar një kandidate tjetër. Paditësja është ankuar Inspektoratit MASHT-it, në raportin e këtij inspektorati është konstatuar se ka pasur shkelje të ligjit me rastin e zbatimit të konkursit, për të cilat shkelje Sekretari i Përhershëm i MASHT-it me vendimin e saj nr. ..., të datës ..., kërkuar nga e paditura që paditësen menjëherë të kthej në vendin e punës dhe të anuloj vendimin mbi pranimin e I. Th...E paditura pretendon se paditësja nuk ka kualifikim të duhur pasi është Inxhinier e Elektroteknikës, ndërsa kandidati i pranuar Inxhinier e Shkencave Kompjuterike, dhe se paditësja është dashur të ri kualifikohet sipas Udhëzimit Administrativ 9/2014.

Gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike ka konstatuar se paditëses i është ndërprerë kontrata e punës në kundërshtim me nenin 10 pika 3 të Ligjit të Punës (nr. 03/L-212), pasi që paditësja të e paditura është në marrëdhënie pune me gjatë se 10 vite, andaj sipas dispozitës në fjalë konsiderohet si kontratë për një periudhë të pa caktuar kohore. Gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike vlerëson se e paditura është e obliguar që paditësin ta kthejë në detyrat e punës që ka pasur sipas kontratës së punës me të ardhurat të përealizuara për periudhat nga largimi nga puna.

Në procedurë të vendosjes sipas ankesës së paditurës gjykata e shkallës së dytë ankesën e ka refuzuar si të pabazuar, duke vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe duke pranuar të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë një herit vlerëson se marrëdhënia e punës së paditëses është e karakterit të përhershëm, pasi që paditësja këto punë i ka kryer më tepër se 10 vite.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke pranuar në tërësi thëniet e qëndrimit juridik të arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë është e mendimit se drejt e ka zbatuar të drejtën materiale gjykata e shkallës së dytë kur ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me të drejtë vlerësojnë se paditësja në bazë të nenit 10.5 të Ligjit të punës (nr.03-L/212), kontratat e lidhura me të paditurin në kohë të caktuar, konsiderohen si kontrata për një periudhë të pacaktuar kohore. Meqenëse paditësja te e paditura është në marrëdhënie pune që nga viti 1991 ka fituar statusin e punëtorit në kohë të pacaktuar dhe se e paditura nuk ka mundur që për këtë vend pune të shpallë konkurs , pasi që sipas nenit 8 të Ligjit të punës, konkursi shpallet vetëm në raste kur janë vendet e paplotësuara të punës dhe se konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët pa asnjë lloj diskriminimi dhe se me shpalljen e konkursit nga ana e të paditurës për vendin e punës së të paditurës, e paditura është diskriminuar. Paditësja është diskriminuar në bazë të gjinisë në kuptim të nenit 1 të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi (nr 05/L 021) dhe e njëjta nuk është trajtuar barabartë me profesorët tjerë te paditura .Ligji në fjalë fushëveprimin ka e dhe për kushtet e punësimit nga neni 2.1 1.3.Prandaj, thëniet e revizionit se e paditura me paditësen ka pasur kontratë pune në afat të caktuar dhe se pas skadimit të afatit të kontratës e paditura ka vepruar konform dispozitave ligjore kur ka shpallë konkurs për vendin e punës së paditëses, nuk qëndrojnë.

Paditësja si punëtore e arsimit që nga viti 1991 te e paditura ka qenë në marrëdhënie pune si mësimdhënëse e lëndës praktikë profesionale dhe se shpallja e konkursit për këtë vend të punës nga e paditura ka qenë e kundërligjshme dhe se paditësja në kuptim të nenit 4 të Udhëzimit administrativ 09/2014 të MASHT-it , nuk ka qenë e obliguar të ri kualifikohet pasi që mosha e saj ka qenë mbi 51 vjet. Prandaj, thëniet e revizionit të paditurës se paditësja është dashtë t'i nënshtrohet rikualifikimit, pasi që për lëndën si mësimdhënëse nuk ka pasur kualifikim, nuk qëndrojnë dhe se në kuptim të dispozitave të Udhëzimit në fjalë paditësja nuk ka qenë e obliguar të ri kualifikohet.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me lartësinë e të ardhurave personale ka caktuar duke marrë për bazë raportin e ekspertit financiar N. U., dhe me këtë rast gjeti se fitimi i humbur për shkak mosrealizimit të ardhurave personale ,është në shumën prej 7,516.76,€ të cilat e paditura është e obliguar të paguajë në kuptim të nenit 173 dhe 174 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, prandaj edhe pretendimet e revizionit se me këtë rast është bërë zbatim i gabuar i së drejtës materiale nuk qëndron.

Nga arsyet e dhëna më lartë, u vendos si në dispozitivë të këtij aktgjykimi me zbatimin e nenit 222

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.283/2018, më 10.tetor.2018

Kryetari i kolegjit,  
Erdoğan Haxhibeqiri